



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 08

Datë: 24. 03. 2023. Ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

- Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes nr. 03 dhe 07/2023

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Aktivitetet e Zyrës

-Njoftim për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike, të vitit 2022, dhe

- Raport për vazhdimin e regjistrimit të partive politike për vitin 2023 dhe rekomandimi.

4. Raportet e Këshillave të KQZ-së

- Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Njoftim për rekomandimet KKZ-ve në komunat Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan për Qendrat e Votimit,

-Shqyrtimi dhe zëvendësimi i Anëtarëve të KKZ-ve në Zubin Potok dhe Zveçan,

-Njoftim për periudhën tre (3) ditore të Fushatës Zgjedhore,

-Shqyrtimi dhe miratimi i fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe fletëvotimeve dhe broshurave për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunat e Zveçanit dhe Leposaviqit 23 prill 2023,

-Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të fletëvotimeve që shtypen për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe numrit të fletëvotimeve dhe broshurave që shtypen për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunat e Zveçanit dhe Leposaviqit 23 prill 2023,

-Rekomandim për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, si dhe Zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq 23 prill 2023,

-Certifikimi i Listës Përfundimtare të Votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunat e Zveçanit dhe Leposaviqit 23 prill 2023

- Këshilli për Marëdhënie me Jashtë

-Shqyrtimi dhe miratimi i Fteses së IFES, për pjesëmarrjen e KQZ-së në Pragë, Republika Çeke

-Shqyrtimi dhe miratimi i Fteses së OSBE, për pjesëmarrjen e KQZ-së në Punëtorinë Rajonale, në Shkup, Maqedonia e Veriut

-Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri

- Njoftim nga Këshilli Mbiqkyrës për Informim Publik

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Fllimish, kryetari paraqiti agjendën e takimit, dhe propozoi që të votohet edhe procesverbali nr. 3, i cili nuk ishte votuar për miratim.

Ilir Gashi, propozoi që të hyjë si pikë e rendit të ditë formimi i një komisioni që do të shqyrtoj dhe trajtoj rregullat deri në një shkallë, e që pastaj ne te merremi ekskluzivisht si KQZ.

Arianit Elshani propozoi që të ndryshohet pika e dytë e KOZ që është “shqyrtimi dhe miratimi i lokacioneve lidhur me QV”, në këtë rast, “jo i lokacioneve”, të ndahen dhe të vendoset “shqyrtimi dhe miratimi i KKZ-ve”, dhe e dyta, “të vendoset shqyrtimi dhe informimit të listës së QV-ve”.

Sami Hamiti, rreth propozimit të Ilirit tha, se deri në qershor rregullat duhet të rishikohen, mirëpo duke u ndërlidhë me draft – ligjin, këto rregulla të brendëshme duhet të ndërlidhen me ligjin e ri...Mirëpo, ato të jenë kompatible me ligjin, edhe nëse formohet komisioni...

Me 10 vota për, miratohet rendi i ditës !

Në vazhdim, me 10 vota për u miratuan procesverbali nr. 3 dhe 7. Mirëpo, **Sami Kurteshi** sugjeroi një përmirësim te fjalia e fundit, fq. 7, “kur nuk ka zgjedhje si kalon buxheti as 35%, kur ka zgjedhje shkon deri në 60%...”.

Čemailj Kurtiš, bëri vërejtje që duhet të citohet, ca më shumë në diskutime...

2. Aktivitetet e Zyrës

Njoftim për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike, të vitit 2022, dhe raporti për vazhdimin e regjistrimit të partive politike për vitin 2023, si dhe rekomandimi:

Besnik Buzhala, tha se, e keni një raport për periudhën aplikimit për certifikim të subjekteve politike për periudhën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunitet e Zveçanit dhe Leposaviqit 23 prill 2023. Sipas planit operacional, periudha e aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe të kandidatëve është ndërmarrë prej 9 mars – deri më 22 mars. Deri më këtë datë në ora 16:00, asnjë subjekt i regjistruar nuk ka dorëzuar aplikimin për certifikim të kandidatëve, dhe asnjë parti politike nuk ka aplikuar dhe as s'ka dorëzuar lista.

Z. Buzhala, në vazhdim bëri një rezymë lidhur me partinë “Kosovski Serba” e cila kishte kandiduar edhe në zgjedhjet e kaluara, ndërsa më 22 mars 2023 ky subjekt përmes miellit në PDF ka dërguar listën e kandidatëve, ndërsa për dy kandidaet e ri, ky subjekt i ka dërguar po të njëjtën ditë formulartë edhe të këtyre kandidatëve...!

Prandaj, zyra rekomandon që KQZ të certifikoj këta dy kandidatë: Miniq Miroslavin dhe Uskoviq Sadja. Nëse këta dy kandidatë certifikohen, atëherë ky subjekt konkurren me një listë prej 18 kandidatë për kuvend komunal.

Ky raport përmban edhe listat e radhitura të subjekteve politike të certifikuar për komunën e Leposaviqit, e që janë: PDK, Lëvizja VV dhe lista e radhitura të kandidatëve të certifikuar...

Në këtë pikë, nuk pati diskutime. Kryetari Radoniqi, e hodhi në votim rekomandimin e zyrës dhe me 10 vota për, certifikoi dy kandidatët e subjektit “Partia Kosovski Serba”...

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Njoftim për rekomandimet KKZ-ve në komunat Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan për Qendrat e Votimit

Shqyrtimi dhe zëvendësimi i anëtarëve të KKZ-ve në Zubin Potok dhe Zveçan:

Arianit Elshani: KOZ ka shqyrtuar rekomandimin e Sekretariatit për nominimin e KKZ-ve për katër komunat ku mbahen zgjedhjet, dhe nga afati i përcaktuar nga KQZ për konfirmim dhe nominim ne kemi 3 konfirmime në komunën e Leposaviqit, dy të tjera rekomandojmë në Zubinpotok nga dy subjekte politike, në Zvecan tre anëtarë të nominuar të KKZ-ve nga subjektet politike dhe në Mitrovicën e veriut kemi katër anëtarë të nominuar të KKZ-ve...

Ndërkohë, ne jemi në pritje të Sekretariatit për të diskutuar që të caktohen ushtruesit e detyrës për të kryesuar KKZ-të, dhe presim që çdo veprim të koordinohet me organet kompetente. Pra, është me rëndësi funksionaliteti dhe, ne rekomandojmë miratimin dhe, po ashtu propozojmë që afati të shtyhet deri të hënen në mënyrë që të konstituohen të gjitha KKZ-të...

Në këtë pikë, diskutuan: Ilir Gashi, Sami Kurteshi, Ibrahim Selmanaj, Të gjitha diskutimet u fokusuan në angazhimin permanent lidhur me koordinimit me institucionet relevante, në mënyrë që aktivitetet e KQZ-së të jenë në shkallë cilësore dhe zgjedhjet të mbahen, por me kujdes të shtuar dhe bashkëpunim me organet e tjera...

Me 10 vota për, rikonfirmohen emërimet e anëtarëve KKZ-ve për këto zgjedhje, si dhe subjektet e tjera që nuk i kanë dërguar anëtarët, zgjatet afati deri të hënen në ora 16:00.

Arianit Elshani, tha se KOZ ka diskutuar listën e rekomanduar për hapësirat e KKZ-ve. Pra, lidhur me këto hapësira, duke e ditur se ato nuk janë funksionale, është konsideruar në komunikim me Ministrinë e Brendëshme të na ofrohen hapësira të mundëshme. Rekomandimi është se, këto hapësira të jenë në kuadër të ARC në këto komuna, dhe se kanë hapësira për zyrtarët tanë. Në të njëjtin vend, do të jenë edhe depot e KKZ-ve. Kemi kërkuar vlerësim që do ta bëjë KQZ lidhur me aspektet logjistike, dhe Sekretariati do t'i shoh këto mundësi...

Sa u përketë qendrave të votimit, ato nuk do të jenë në të njëjtin vend...

Sami Kurteshi, tha se kjo është një ide dhe veprim shumë i mirë, një zgjedhje e mirë...

Pastaj, me 10 për u miratuan këto zyra...

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar edhe listën e rekomanduar nga Sekretariati të QV-ve. Janë 7 qendra në Mitrovicë të veriut, 7 QV në Zveqan, 12 qendra në Zubin Potok, dhe 18 në Leposaviq. Të njëjtat ne i kemi miratuar si këshill, dhe Sekretariati ti vlerësoj bashkë me ministrinë nëse këto qendra janë të mundshme të hapen, kanë siguri. Deri të hënen presim konfirmim, dhe pastaj i hedhim në votim në mbledhje... Në këtë temë, diskutuan: Ilir Gashi, i cili tha se ende nuk mund të konstatojmë se a mund të hapen, pra cila mund të jetë qasja, ushrimi i të drejtës së votës së qytetarëve...

Arnit Elshani, tha se të shohim, në fund kemi diskutuar edhe ndryshimin e formatit, gjetjen e alternativave tjera... **Čemailj Kurtiš**, tha se shembulli i Gashit është me vend, deri të hënen ndoshta është është herët pak, më mirë është të vlerësojmë, të shohim cilat mund të jenë alternativat. Nëse ka pengesa teknike, atëherë të marrim masat...

Sami Hamiti, tha se ne i kemi miratuar QV-të. Tash i vlerësojmë, duhet komunikojmë menjëherë atje, janë edhe organet që vlerësojnë...edhe ne, duhet ti analizojmë mirë...

Shqyrtimi dhe miratimi i formimit të komisionit për analizën dhe vlerësimin e rregullave, kompatibil me reformën zgjedhore:

Ilir Gashi, tha se mirë është të formohet një komision, ashtu sic e kemi formuar për rregullat zgjedhore, dhe pastaj ata ti përpunojnë dhe vlerësojnë se cilat janë mundësitë e ndryshimeve. Unë, tha Gashi, e propozova formimin e këtij komisioni që pastaj, pas vlerësimit të tij në bazë të planit të punës, ne mund ti shohim dhe të konstatojmë se cilat janë ndryshimet e nevojshme ...

Alban Krasniqi, tha se kjo në fund vjen të këshillat, te anëtarët për miratim. Këshillat, mund të jenë trupat që mund të shërbjenë sipas natyrës së këtyre rregullore

pra me e trajtue edhe harmonizimin e tyre...sipas kontributit, sekretariati duhet ta ketë pjesën e vet...Unë e di që ka pas një vendimmarrje, ka pas zvarritje, dhe jemi tash në një situatë që duhet ta shtyjme përpara procesin...

Po këto rregullore, duhet të jenë në harmoni edhe me ligjin e ri...

Pra, disa rregullore është uregjenete të shtyhen përpara...

Illir Gashi, tha se sekretariati, ta sjellë versionin e parë dhe pastaj, së bashku në një punëtori mund ti trajtojmë së bashku...

Në vazhdim, diskutoi edhe **Arianit Elshani**, i cili kërkoi nga sekretarati propozimin e një komisioni prej tre vetash, dhe të kemi edhe një afat, se nuk duhet harruar që afat e kemi qershorin sipas planit të punës...

Alban Krasniqi, tha se duhet të angazhohen këshillat, të autorizohen dhe të angazhohen edhe anëtarët...kurse nga 3 anëtarë të caktohen nga Sekretariati...për këshillat...

Sami Kurteshi: Sa rregulla janë për tu punuar, e përvoja ime është se ne i kemi pru në njëfarë forme, dhe mendoj se në mbledhjen e ardhshme, kryeshefi të na tregojë sa rregullore janë, cilat janë, dhe a ka planifikue grupet punese...

Kreshnik Radoniqi, tha se këshilli për personel mundet me qenë i përfshirë, dhe këshillat e tjerë, por mendon se mirë ish kanë me kërkue ndihmë edhe nga zyra britanike...Mirë...

E kemi propozimin për formimin e komisionit...?

Arnait Elshani: Këshilli për personal ta merrë përsipër me sekretariatit..

Në fund, me 10 vota për u miratua formimi i grupit punuës.

Sami Hamiti: Sekretariati duhet me i ba propozimet, me i sjellë të ne, dhe mandej ne i shqyrtojmë dhe miratojmë...

Pjesa e dytë:

Alban Krasniqi, tha se është një numër relativisht i vogël për të aplikuar. Pra, ka mundësi që kjo nuk e siguron kualitetin, dhe kanë aplikue shumë pak, dhe se dimë nëse kjo mund të na kthehen bumerang...Për procesin në Mamushë, ajo që dihet dhe është lehtë e verifikueshme, dhe se procedurat janë zhvilluar ashtu që ja kanë mundësuar marrjen e kësaj pozite një qytetari që as nuk është turk, por as nuk është i asaj komune. I njëjti, njihet prej sekretariatit, ka përvojë në proceset si staf permanentë...

Personi në fjalë, është banorë i Suharekës që e ka ndryshuar letërnjoftimin: është bërë banorë i Mamushës, por ai nuk jeton aty...

Z. Krasniqi, i zbërtheu gjerë e gjatë çështjet që lidhen me dështimet, problemet, anulimet e konkurseve por edhe implementimin e tyre, duke dhënë mendime, shpjegime dhe elemente, qoftë të atilla që kanë qenë në kundërshtim me procedimin e tyre, dhe qoftë elemente që bien ndesh me ndjekjen e procedurave, me respektimin e ligjit, me transparencën etj. Ai, po ashtu foli edhe për momentet shqetësuese që janë shfaqur, shkeljet e bëra dhe mori si shembull ‘rastin e konkursit për KKZ të Mamushes’ dhe tha në vazhdim se, madje komisioni pranues e ka ditë që kandidati i pranuar nuk është banorë i Suharekës, njihet në Sekretariat sepse ka punuar me KQZ-në.

Duke marrë si shembull procedimin e konkurseve, z. Krasniqi tha se deri sa në komunën e Mamushes nuk ka psur shtyerje të konkursit por është realizuar me të parën, në dy komunat tjera ka pas zgjatje të afatit. Për raste e dy komunave tjera, Malishevë dhe Lipjan...! Unë, e kam konsultuar zyrtaren e personelit, dhe dihet se pse shtyhet konkursi dhe mbi çfarë specifikash shtyhet...

Tash, unë e di që prezumimi i pafajsisë është parim që duhet me u ruajt, por unë e di që në administratë në çfarëdo procesi kushdo që hynë që është subjekt i drejtësisë, automatikisht personeli duhet me u kujdesë që ata persona nuk duhet me u përfshi në procese, sidomos të natyrës së njëjtë që iks zyrtari ka qenë i përfshirë !

Po ndalem te aspektet ligjore, unë i kam shikuar ligjet, aktet nënligjore që rregullojnë funksionin e komisioneve të pavaruara. Mendoj që jemi para dy opcioneve, ndërsa që

unë e shoh vetëm një: Sa ma shpejtë me fillue hartimin e rregullores së re që është në përputhje me legjislacionin e ri, me kushtetutën, dhe me ju përmbajtë standardeve që sigurojnë transparencë, llogaridhënie...

Ndoshta, për shkak se rregullorja ka probleme në bazën ligjore, është e stërvjetëruar të anulohen të gjitha konkurset që janë të hapura, dhe deri në fund të qershorit të kryhet ky proces, presim të bëhet edhe ligji i ri dhe të vazhdohet...

Ky është rekomandimi që e kisha dhënë, kuptohet si kryesues i komisionit, pavarësisht se mund të ketë edhe mendime të tjera, dhe s'ka gjë të keqe në këtë drejtim...

Kreshnik Radoniqi, tha se së pari, një vendim i gjykatës Kushtetuese i marrë më 9 korrik 2020, është dashur me veprue më shpjet me i ba rregulloret, ashtu sic kanë vepruar edhe komisionet e tjera. Pra, KQZ ka ngecë në këtë drejtim, dhe për këtë unë kam instistuar. Megjithatë, tash duhet ti kryejmë, e dyta, vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me shfuqizimit të Ligjit për Shërbyesit Civil, e thotë në pikën e dytë, e thotë : “që, nenet...”, si për shembull neni 85 i ligjit për zyrtarët publik nuk janë në përputhshmëri me nenet...për institucionet e pavarura.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet ligji për shërbimin civil. Ky vendim, e ka shfuqizu “shfuqizimin” e ligjit për shërbimin civil, andaj, thotë: “përderi sa nuk cënohet pavarësia institucionale mundet mu zbatu ky ligj”.

Kjo, nuk është e vlefshme vetëm për ne por, edhe për institucionet e tjera.

Në këtë pikë, diskutoi edhe **Sami Hamiti** i cili tha se duhet punuar që rregullat të punohet sa më shpejtë, por procedurat duhet ndjekur. Me i ba rregullat. Të meanxhohen burimet njerëzore, me ligj. Duhet me u zbatue. Sugjerim i imi është të punohet, të bëhet komisioni, të rregullohet dhe të shihet se cka duhet bërë por, kujdes procedurat. Mos me krijue precedent, vjen ligji ri dhe zbatohet...

Burim Ahmetaj, tha se për rastin e Mamushes kemi kërkuar nga zyra e personelit ti bëjmë disa verifikime shtesë. Kemi kërkuar prova, dëshmi etj.

Ilir Gashi, tha se gjithë këto diskutime na shërbejnë për ti ndryshuar rregullat të cilat, na shërbejnë për të ardhmen. Ndërsa, sic po thuhet, unë jam për anulimin e konkursit

nëse gjenden elemente për tu anuluar konkursi, por duhet pasur argumente që çështja mos të përfundoj në gjykatë...

Në këtë fazë, nëse kryeshefi ka elemente le ta eliminojë konkursin, ne s'mund ta bëjmë...Rasti është specifik, do trajtim por, me letra është problem.

Në këtë pikë, diskutuan: **Kreshnik Radoniqi**, i cili tha se nëse ka shkelje procedurale mund të anulohet, duhet me ditë ku është rreziku.

Arianit Elshani, po ashtu tha se kemi miratuar një plan rekrutimi, ishte edhe dakordim i KQZ për shpalljen e vendeve të lira, dhe tha se kemi formuar komisionin për rregulloret. Gjithashtu, ai foli edhe për nevojën se rreth referencve ligjore, duhet të përcaktohem përfundimisht. Ai, diskutoi gjerë e gjatë edhe rreth konkursit për KKZ-në në Mamushë.

Sami Kurteshi, tha se konkursi është shkelë, personi është zgjedhur me të njoftshëm...Janë disa gjëra që ne, i dimë, dhe gjërat po i mbulojmë me letër. Nuk jamë përzi në çështje të personelit, por nuk ka asnjë konkurs që nuk ka hile etj.

Lidhur me konkuret, diskutuan më tej: Burim Ahmetaj, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Ilir Gashi dhe Kreshnik Radoniqi.

